



Olsi Jazexhi

1.

Në këto ditët e fundit, muslimanët shqiptarë janë përballur me një seri ofendimesh që u kanë ardhur nga pushtetarët e tyre në Prishtinë e në Tiranë. Këtu nuk e kam fjalën për dhunën shtetërore që regjimi i Hashim Thaçit organizon kundër femrave me shami në Kosovë, të cilat kanë nisur të largohen nga vendi i tyre për në Turqi si muhaxhire, siç bënin të parët e kosovarëve në kohë të Rankoviçit. Këtu po shkruaj për ofendimet historike dhe fetare. I pari ofendim erdhi nga Zymi i Hasit më 15 tetor 2011. Presidentja jo-demokratikisht e emëruar e Kosovës, Atifete Jahjaga, në tubimin e organizuar nga Kisha Katolike dhe klubi letrar “Shtjefën Gjeçovi” ka sulmuar fenë e kosovarëve, Islamin. Tubimi “Takimet e Gjeçovit” ishte organizuar për të përkujtuar priftin Shtjefën Gjeçovi i cili propagandohet nga Kisha Katolike si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë si hero i kombit shqiptar. Shtjefën Gjeçovi apo Mëhill Kostandin Gjeçi është një nga mercenarët françeskanë të shekullit të XX i cili nëpërmjet parave që merrte nga austriakët e më pas italianët u kthye në një nga “inxhinierët socialë” të nacional-katoliqizmit shqiptar të viteve 30 i cili synonte nënshtrimin dhe deislamizimin e shqiptarëve ndaj Italisë. Gjeçovi ashtu si Fishta, Harapi etj u ngritën në majat e albanologjisë shqiptare pas krijimit të shtetit shqiptar, pasi pas tyre qëndronte një investim marramëndës lirtash italiane. Ministri i jashtëm italian, baroni Sidney Sonnino i deklaroi parlamentit italian në vitin 1919 se pas mundjes së Austro-Hungarisë në Luftën e Parë Botërore, Italia duhet të merrte nën patronazh klerin katolik në Shqipëri pasi ata ishin agjentët e imperializmit kulturor të tyre mbi shqiptarët. Kjo është arsyeja pse pas krijimit të shtetit shqiptar në vitet 1920, ndërsa hoxhallarët muslimanë

dhe priftërijtë ortodoksë vdiqën për bukën e gojës në Shqipëri, një seri priftërijsh franceskanë dhe jezuitë jo vetëm që u bënë politikanë, por kishin luksin të merreshin edhe me shkencë dhe u rrëfenin kombin shqiptarëve. Pas tyre qëndronte imperializmi italian i cili u kurorëzua me pushtimin e Shqipërisë në 1939.

Shtjefën Gjeçovi ishte një nga priftërijtë albanologë i cili u shqua në fushën e albanologjisë në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të kaluar. Ai përlëvdohet nga albanologët nacional-katolikë për përmbledhjen që i ka bërë Kanunit të Lekë Dukagjinit, ligjit të fiseve katolike shqiptare, si pasojë e të cilit sot në Kosovë dhe në Shqipëri shohim sesi vriten e ngujohen me qindra familje. Katolikët kishin nevojë ti tregonin muslimanëve se edhe ata kishin ligje e për këtë arsye vepra e Gjeçovit rrëfëhet si art.

Kanuni i Lekë Dukagjinit është një nga ligjet më të egra që mund të ketë prodhuar ndonjëherë shoqëria njerëzore. Ai ka qenë në njëfarë mënyre “sheriat” i Kishës Katolike e cila e përdorte për të nënshtruar, mbajtur në injorancë dhe ruajtur nga Islami fiset katolike shqiptare. Ndërsa dhunon dhe nuk njeh të drejtat e grave, Kanuni ka qenë transmetuar gojarisht në komunitetet analfabete katolike nga priftërijtë dhe pleqtë e tribuve si një ligj i cili vendoste rregullat e luftës dhe jetës. Me gjithë natyrën e papranueshme për kohën dhe vlerat moderne ku ne jetojmë, Kanuni, në vend që të denoncohet si një ligj i frikshëm i një të kaluarë mesjetare dhe të lihet të studiohet nga antropologët si një formë primitive ligjvënies, ai është nderuar nga presidentja e Kosovës në fjalimin që ka mbajtur para prelatëve të Kishës Katolike.

Problemi më i madh i fjalimit të Jahjagës nuk ishte pse ajo mbronte një ligj primitiv, i cili nëse do ishte në ekzistencë nuk do e lejonte atë të bëhet presidente, të ketë pronën e saj, të ketë të drejtë të ndajë burrin dhe të jetë grua e lirë. Problemi më i madh në fjalimin e Atifetes është kur ajo thotë:

“Me Kanunin e Maleve të njohur si Kanuni i Lekë Dukagjinit, pasardhësit të Skënderbeut në rezistencën kombëtare kundër pushtimit otoman, rregullohet jeta e njerëzve, dhe kjo e pamundësonte zbatimin e Sheriatit në këto troje dhe te populli ynë, qoftë i besimit katolik apo i besimit musliman. Në trojet shqiptare nuk mund të paramendohej që autoritetet osmane t’ia këpusnin dikujt dorën, të akuzuar për vjedhje, ose që dikujt t’i jepeshi pesëdhjetë kamxhik publikisht trupit. Pra ky Kanun ruajti nderin dhe dinjitetin e njeriut dhe dinjitetin kombëtar gjatë më shumë se pesëqind vjetëve.”

Në paragrafin më lartë, Atifeteja apo më saktë fanatikët katolikë që ia kanë shkruar këtë shkrim, pretendojnë se “në trojet shqiptare” “populli ynë qoftë i besimit katolik apo i besimit musliman”

nuk ka zbatuar sheriatin. Presidentja pretendon se shqiptarët janë qeverisur me kanun, në mënyrë që t'i rezitojnë kombëtarisht turkut. Duke qënë se Atifetja është police dhe mesa di unë, nuk di as të shkruaj e as të lexojë shqip si duhet, duhet ti sqaroj se gjyshërit e saj dhe të gjithë qytetarët osmanë shqiptarë që nga Presheva e deri në Gjirokastrë, deri në vitet 1945 në Kosovë e 1920 në Shqipëri janë qeverisur me shariat dhe jo me kanun. Kanuni nuk ka qënë ligj i shqiptarëve, por vetëm i disa fisesh malësore të Mirditës e Dukagjinit, të cilat hanin mish thiu dhe jo mish lope, flinin nëpër kulla dhe jo në shtëpi, hanin në tokë dhe jo në sofër, laheshin rrallë dhe jo pesë herë në ditë, nuk shquheshin për higjenë pasi nuk i njihnin banjot dhe hamamet e si pasojë vuanin në masë nga sifilisi dhe sëmundje seksuale, e hajdutit nuk i'a prisnin dorën apo t'a rrihnin me kamzhik siç kërkonte sheriati, por kur i vidhte dikush fillonin e vriteshin me njëra tjetrën. Vrasjet ishin aq monstruoze sa në ciklin e tyre nuk kurseheshin as fëmijët në djep e as pleqtë në varr. Sikur të mos ishte ndërhyrja e muslimanëve dhe pashallarëve shqiptarë nga kazatë e Shqipërisë e Kosovës për të shtruar *fandët* e vendosur ligjin qytetërues të sulltanit, sot, në malësitë tona nuk do të kishte këmbë katoliku.

Ndërsa sheriati islamik i njihte femrës të drejtën e pronës, të ndarjes së burrit dhe tolerancës ndaj feve të tjera, Kanuni i Lekë Dukagjinit, grave katolike nuk u njihte as të drejtë prone, as ndarje dhe as liri fetare. Arsyeja pse në Mirditë nuk ka patur këmbë muslimani deri me ardhjen e komunizmit, e ndërsa në Tiranë ka patur raja katolikë që nga koha e turkut është se Kanuni ishte një ligj intolerant që mbyste çdo jo-katolik, ndërsa sheriati toleron fetë e tjera dhe i jep grave liri, si ato që Atifetja gëzon sot në Kosovë. Sikur në Kosovë, largqoftë, të zbatohet Kanuni i Lekë Dukagjinit, Atifetja nuk do të ishte presidente e Kosovës, vendi nuk do të gëzonte tolerancën fetare që ka, dhe Don Lush Gjergji, Dodë Gjergji dhe prelatët e tjerë katolikë do ja mbysnin fisin Atifetes ashtu siç propozoi Don Anton Kqira përpara ca vitesh në SHBA. Sikur Kosova të qeverisej me Kanun, Atifete Jahjaga nuk do të kishte të drejtë të mbante fjalim përpara Don Lush Gjergjit dhe Dodë Gjergjit këtë 15 tetor 2011, por, me një legen me ujë në dorë do të duhej t'u lante këmbët patriarkëve katolikë.

2.

Sulmi që Atifetja i ka bërë Islamit në Kosovë, ka patur precedentët e tij edhe në Tiranë. Në 30 shtator 2011 në fjalimin që president Bamir Topi mbajti në pritjen e Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore të Evropës, u deklaroi priftërijeve katolikë evropjanë që ishin mbledhur në Tiranë se heroi kombëtar i Shqipërisë, Gjergj Kastriot Skënderbeu ka qënë aleat i Selisë së Shenjtë kundër "otomanëve" dhe se Vatikani ka mbështetur prelatët shqiptarë si Buzuku, Budi, Bogdani e Bardhi për të kultivuar gjuhën, kulturën dhe identitetin kombëtar shqiptar. Sipas fjalimit të Bamirit, Vatikani dhe priftërijtë e tij tregohen si shpëtimtarë të Shqipërisë, ndërsa osmanët dhe ata që i mbështetën si armiq. Kur lexova deklaratën e Bamirit desha të bëja një shkrim e ta pyesja nëse është përnime djali i Myrteza Topit apo mos e ka zënë e ëma me

ndonjë katolik? Nga emri i të atit dhe me aq sa unë e njoh Topin e di që është musliman. Duke qënë i këtillë i bie që të parët e tij nuk kanë qënë me kaurët e Vatikanit, por me osmanët çlirimtarë të cilët na bënë muslimanë e na shpëtuan nga Selia e Shenjtë dhe Kanuni. Për rrjedhojë herojtë e Bamir Topit nuk janë Skënderbeu, por janë Hamza Kastrioti dhe Ballaban Pasha, Ethem Beu dhe Kapllan Pasha, falë të cilëve fisi i Bamirit sot është musliman. Megjithatë, si i thonë fjalës në Tiranë, nëna dihet e baba nuk para dihet. Për këtë arsye vendosa që të mos e ngas Bamirin, por u mjaftova vetëm duke thënë pastë rahmet i ati dhe gjyshi për djalin që kanë lënë pas.

3.

Por edhe pse Topi iu përul priftërijve të Papës sikur të ishte djali i Prengës dhe jo i Myrtezait, katolikët nuk e begenisën servilosjen e tij. Në replikat që ka zhvilluar me Jozefina Topallin në mes të muajti tetor, cubnesha katolike e Berishës e ka sulmuar Bamirit dhe Edi Ramën si fajtor të vonimit në procesin e integritetit evropjan të Shqipërisë. Bamiri i cili është prekur nga komentet rrugaçërore të Jozit i ka kërkuar që “të mësojë ...artin e komunikimit qytetar”, “të dijë të komunikojë në mënyrë etike” dhe të “ta flasi gjuhën shqipe në mënyrë korrekte”. Edhe pse në këtë rast Bamiri ka patur të drejtë, Jozefina i është përgjigjur në toskërisht duke thënë:

“Flas me krenari dhe vetëdije shqipen më të bukur, flas me krenari atë shqipe që foli Fishta, Migjeni dhe Gurakuqi. Atë gjuhë Haxhi Qamili nuk e kupton dot.”

Pas përgjigjes së Jozefinës, katoliku Aleksandër Frangaj i lëshoi Bamirit televizionin Klan, i cili kërkesën e Bamirit ndaj Jozefinës për t'u sjell mirë e ka kthyer në një betejë gego-toske. Nga televizioni Klan e deri te gazeta 55 e Fahri Balliut, Bamiri është akuzuar si anti-gegë. Fahri Balliu, Fadil Kraja, Qendra Kulturore “Pjetër Gaçi” dhe “2 Prilli” kanë akuzuar për anti-gegë, presidentin gegë të Tiranës. Çfarë të bën përshtypje në reagimet e shkodranëve është se që nga Jozefina, Fadil Kraja, Erzen Koperaj, Qendra Kulturore “Pjetër Gaçi” e “2 Prilli”, që të gjithë e kanë identifikuar gegënishten me Shkodrën, Fishtën, Migjenin, Gurakuqin, Buzukun, Budin, Bardhin, Bogdanin, Formulën e Pagëzimit dhe katoliçizmin. Tirana, Elbasani, Durrësi, Kruja, Kosova, Shkupi etj nuk përmenden askund.

Gazeta 55 në shkrimin me titull “Bamir Topi, mes Haxhi Lleshit dhe Haxhi Qamilit”, ndërsa ofendon dy gegë muslimanë, Haxhi Qamilin dhe Haxhi Lleshin, e tregon Bamirin si një obskurantist komunisto-osman. Gegët muslimanë i ka ofenduar edhe Berisha në fjalimin që ka

mbajtur në parlament më 13 tetor 2011. Ai ka sulmuar Esat Pashën dhe Haxhi Qamilin duke deklaruar se “atë që i kanë bërë Toptanët dhe Haxhiqamilët, Shqipërisë, nuk ia kanë bërë të gjithë okupatorët.”

Replikat ndërmjet Topit dhe Topallit dhe sulmet e Berishës kundër Esat Pashës dhe Haxhi Qamilit, tregojnë sesi sot në Shqipëri flamurin e “gegëizmit” e kanë rrëmbyer katolikët. Në datë 13 tetor 2011 gazeta shqiptare tregonte sesi Muzeu i Krimeve të Komunizmit në Shqipëri po ndërtohet në Shkodër në ndërtesën e françeskanëve, për të treguar kështu që edhe herojtë e anti-komunizmit janë katolikët. Rreshtimi i Shkodrës (pjesës katolike), Fishtës, Migjenit, Gurakuqit, Buzukut, Budit, Bardhit, Bogdanit, Formulës së Pagëzimit, françeskanëve etj si krenari e kombit nga Jozefina Topalli, Fadil Kraja, Qendra “Pjetër Gaçi” dhe qeveria Berisha tregojnë racizmin e fortë që klanet katolike të Berishës e Jozefinës kanë kundër gegëve muslimanë. Sulmi që i bëhet muslimanëve të Tiranës nga katolikët nuk është i ndryshëm nga ai që ka bërë Atifetja në Kosovë kur i ka sharë sheriatin muslimanëve kosovarë e lavdëruar kanunin e katolikëve.

Si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri ne shohim dy presidentë muslimanë të cilët ndërsa i servilosën Vatikanit dhe katolicizmit, në momentin e parë që përplasen me katolikët, refuzohen e ekskomunikohen si Esat Pashë, Haxhi Qamilë dhe anti-gegë. Edhe pse qyteti i Shkodrës ka ngelur pjesë e Shqipërisë dhe kauresha Jozefinë sot flet shqip falë luftës që bën gegët e Esat Pashë Toptanit, Haxhi Qamil Xhametës, Musa Qazim Beqarii e mijëra luftëtarë muslimanë që erdhën nga Shqipëria e mesme dhe e veriut për ta mbrojtur, në një kohë që fiset katolike ishin rreshtuar përkrah serbëve e malazezëve dhe vrisnin muslimanët e Shkodrës nën udhëheqjen e Ded Gjo Lulit, muslimanët gegë janë ata që tregohen si të këqij. Dhe Jozefina në vend që t'i thotë ejvallah Esat Pashës e Haxhi Qamilit lavdëron katolikët e Italisë.

Sulmi ndaj “Haxhiqamilit” Bamir Topi dhe sulmi që Berisha i bën Esat Pashës janë sulme kundër gegëve të Shqipërisë së Mesme. Sulmi drejtohet kundër tironsave të cilët Ismail Kadareja i quan turq e Kristo Frashëri që Bamir Topi e ka dekoruar si “nderi i kombit” i quan fundamentalistë islamikë. Janë këta tironsa të cilët që me vrasjen e Esat Pashës në vitin 1920 e deri më sot, vetëm se i kanë abuzuar, dhunuar, vrarë, treguar si injorantë e u kanë vjedhur pronat dhe qytetin. Në tokat e tyre sot sundon klani katolik i Jozefinës dhe cubat e Berishës. Këta tironsa që sot rrinë urtë dhe nuk bëzajnë kur shohin sesi u sulmojnë të kaluarën, janë viktimat më tragjike të konfliktit ndërshqiptar të mëse një shekulli. Konflikti nuk është ndërmjet gegëve dhe toskëve siç mundohet ta portretizojë dikush, por ndërmjet katolikëve dhe muslimanëve. Por tironsave mirë t'ua bëjnë. Për sa kohë që ata prodhojnë njerëz si Bamir Topi i cili zyrën e tij në vend që ta mbushi me portrete të Dervish Hatixhesë e të krenohet me pashallarët e hoxhallarët e Tironës, e ka kthyer në teqe të Nënë Terezës dhe priftërijeve të Vatikanit - të cilëve u përgjërohet si legen duke u thënë që jemi me Vatikanin kundër turkut, edhe katolikët e Jozefinës mirë bëjnë që i poshtërojnë. Në pozita të ngjashme qëndron edhe Atifete Jahjaga, e cila ashtu si Bamir Topi në vend që të lavdërojë sheriatin e gjyshërve të saj

agallarë, shkon e i bën qejfin xhahilëve të Kishës Katolike. Besoj se edhe Atifetja por edhe Berisha fatin e Topit do ketë herët apo vonë. E si pasojë herojtë e Shqipërisë do të vazhdoj t'i përaktoj Papa i Romës, i cili ka detyruar shqiptarë e Shqipërisë dhe të Kosovës që në çdo datë 18 tetor t'i përulen si raja Nënë Terezës dhe jo Esat Pashës apo Dervish Hatixhesë.